




INSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË PUBLIKE TË KOSOVËS



SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCË, COVID-19 DHE PATOGENËT TJERË RESPIRATORË NË KOSOVË, SEZONA 2025/2026 (JAVA 44-TË)

Simptomet e Gripit përfshijnë:

- Temperaturë/ethe
- Kokëdhimbje
- Lodhje
- Kollë e thatë
- Dhimbje fyti
- Rrjedhje hundësh
- Dhimbje muskulare
- Simptome gastrointestinale, si nauze dhe barkqitje




PËRMBLEDHJE

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike gjatë tërë vitit bën mbikëqyrjen permanente të Influcencës sezonale (ILI), ARI dhe SARI me intensifikim të aktiviteteve gjatë sezonës përkatëse. Mbikëqyrja realizohet përmes hulumtimit aktiv dhe pasiv në institucione shëndetësore dhe terren.

SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCËN SEZONALE NË KOSOVË, 2021/2022 - 2025/2026

Sipas grafikonit 1, ku janë paraqitur rastet e Influcencës sezonale (ILI) në 5 sezonat e fundit shohim se sezona 2025/2026 karakterizohet me numër më të ulët të rasteve të raportura, krahasuar me periudhën e njëjtë të sezonës 2024/2025 dhe fillim të aktivitetit nga java e 40-të e sezonës 2025/2026.

Grafikoni.1



SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE ME INFLUENCËN SEZONALE NË KOSOVË, 2025/2026 DHE PRAGU EPIDEMIK


Nga fillimi i sezonës, 29 shtator 2025 deri më 2 nëntor 2025 (java e 44-të) në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës janë raportuar 5,714 raste të Sëmundjes të ngjashme me Grip (ILI), 1,322 raste të Infeksioneve respiratore akute (ARI) dhe 7 raste me Infeksion të rëndë respirator akut (SARI).

Gjatë javës së 44-të (27.10.2025-02.11.2025) janë raportuar 1,195 raste ILI (Sëmundje e Ngjashme me Gripin), 311 raste ARI (Infeksion Respirator Akut) dhe 1 rast me SARI (Infeksion i Rëndë Akut Respirator).

Përmes sistemit të mbikëqyrjes së sëmundjeve ngjitëse dhe paralajmërimit të hershëm (SMSN) janë raportuar 348 raste ILI dhe 8 raste ARI.


Intensiteti i Influcencës sezonale sipas numrit të rasteve të raportuara për javën e 44-të paraqitet në aktivitetin e ulët të qarkullimit dhe krahasuar me javën e kaluar shënon rënie prej 7%. (Graf.2)


Grafikoni.2



Në grafikoni 3 shohim se në të gjitha komunat janë raportuar raste të dyshimta në Influcencë dhe sipas numrit të rasteve të raportuara, numër më të lartë kanë komuna e Prishtinës, Prizrenit dhe Pejës ndërsa sipas Incidencës numër më të lartë të rasteve kanë komuna e Kamenicës dhe Pejës.


Grafikoni.3





Në raport me distribuimin e rasteve sipas grup-moshës dhe incidencës, nga numri total i rasteve të raportuara me ILI, shihet se të gjitha grup-moshat janë të atakuara derisa sipas Incidencës; grup-mosha 0-4 dhe mbi 65 vjeç. Sa i përket rasteve me ARI, grup-mosha më e atakuar është 0-4 vjeç (894 raste) pastaj grup-mosha 5-14 vjeç (180 raste), 15-64 vjeç (169 raste), dhe grup-mosha 65+ vjeç (79 raste). (Graf.4)

Grafikoni.4




MBIKËQYRJA VIROLOGJIKE

Në laboratorin e Qendrës Kombëtare të Influcencës – IKSHPK nga fillimi i sezonës 2025/2026 deri me 5 nëntor 2025, janë testuar gjithsej 781 mostra nga pacientët e qendrave sentinel dhe jo sentinel si raste të dyshimta në ILI, ARI dhe SARI. Nga mostrat e testuara 392 (50.19%) prej tyre të dyshimta në SARS-CoV-2 dhe 389 (49.8%) të dyshimta në Influcencë dhe patogjenët tjerë respiratorë. Gjatë kësaj periudhe në SARS-CoV-2 janë konfirmuar 16 raste (4.08%). Nga 389 mostrat e testuara në Influcencë dhe patogjenët tjerë respiratorë janë konfirmuar 5 raste me Influcencë A (pozitiviteti 1.28 %). Rastet e konfirmuara me Influcencë A janë nga komuna e Prishtinës (3 raste), Ferizaj (1 rast) dhe Viti (1 rast) dhe i takojnë grup-moshës 0-4 vjeç (2 raste), 5-14 vjeç (2 raste) dhe 35-50 (1 rast). Gjatë javës së katërdhjetë e katër (27.10.2025-02.11.2025), nga laboratorët private janë raportuar gjithsej 53 mostra të testuara si të dyshimta në SARS-CoV-2. Nga këto mostra nuk është konfirmuar asnjë rast pozitiv. Nga patogjenët tjerë respiratorë, janë konfirmuar: 29 mostra me RSV, 96 mostra me Human Rhinovirus, 50 mostra me Human Adenovirus dhe 10 mostra me Parainfluenza Virus (*Graf.5*).


Rastet pozitive në RSV (7.5%), janë nga komuna e Prishtinës (16 raste) dhe Fushë Kosovë (11 raste), Podujevë (1 rast) dhe Gjiilan (1 rast) dhe i takojnë grup-moshës 0-4 vjeç (25 raste), 5-14 (2 raste), 35-50 (1 rast) dhe 65+ (1 rast) (*Graf.5*).

Grafikoni.5



Sipas subtipit: me subtipin AH3 është konfirmuar një rast apo 33%, me subtipin AH1N1 janë konfirmuar 2 raste apo 67% dhe me Influcencë A të pa subtipizuar janë konfirmuar 2 raste apo 40%. (Graf.6.)

Grafikoni. 6



AKTIVITETET SEZONALE

IKSHPK/Departamenti i Epidemiologjisë bënë mbikëqyrjen e Influcencës gjatë tërë vitit, me intensifikim të saj gjatë sezonës përkatëse (java e 40 deri në javën e 20).

Përcjell situatën epidemiologjike me rastet ILI/ARI (javore) dhe rastet me SARI (në bazë ditore/alerti).

Bënë testimin laboratorik të mostrave në Departamentin e Mikrobiologjisë/Qendrën Kombëtare për Testimin e Influcencës.

Ka dhënë këshilla për popullatën për mbrojtjen nga sëmundja dhe njohjen e simptomeve të saj.

MASAT PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË VIRUSIT TË GRIPIT SEZONAL

Aktiviteti i gripit për sezonën 2025/2026, është në nivel më të lartë krahasuar me sezonën paraprake dhe masat për parandalimin dhe kontrollin e infeksioneve respiratore janë:

Mbajtja e maskave.

Distanca fizike.

Higjiena e duarve.

Evitimi i kontakteve të afërta me individë të sëmurë.

Redukimi i vizitave të familjarëve tek personat e hospitalizuar (SHSKUK, Spitalet rajonale).

Evitimi i vendeve të mbyllura dhe të mbingarkuara me njerëz.

Ushqimi i shëndetshëm me shumë vitamina.

Aktiviteti fizik dhe gjumë i mjaftueshëm.

Personat e sëmurë të qëndrojnë në shtëpi.

- Pastrimi dhe dezinfektimi i mjediseve ku qëndroni.
- Mbulimi i hundës dhe gojës me një shami gjatë teshtitjes dhe kollitjes si dhe huthja më pas në vend të sigurt.
- Larja e duarve shpesh me ujë dhe sapun, ose solucione duarsh me alkool.
- Sytë, hunda dhe goja të mos preket me duar të kontaminuar, pasi virusi përhapet në këtë mënyrë.
- Pastrimi dhe dezinfektimi i sipërfaqeve dhe objekteve që mund të jenë kontaminuar nga virusi.

Konsultimi me mjekun për mjekimin me barna kundër gripit, të cilat duhet të merren vetëm me rekomandimin e mjekut

Medikamentet kundër gripit duhet të fillohen brenda 48 orëve të para të fillimit të sëmundjes për të pasur efektivitet të lartë.

Ato mund të parandalojnë edhe komplikimet e rënda që mund të vijnë nga gripit.

Mënyra më efikase për parandalimin e virusit të gripit është Vaksinimi me vaksinën kundër gripit.

- Vaksinimi mbron vetë personin dhe ndihmon në parandalimin e përhapjes së gripit.
- Efekti i vaksinës fillon 1 deri 2 javë pas marrjes dhe mbrojtja vazhdon rreth një vit pas vaksinimit.

VAKSINIMI

Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me IKSHPK në fillim të sezonës së gripit 2025/2026 ka siguruar 85,000 doza të vaksinës sezonale) dhe me fillimin e sezonës ka filluar vaksinimi sipas rekomandimeve. Deri më 15 tetor janë administruar gjithsej 25,642 doza të vaksinës kundër gripit sezonal.

HOSPITALIZIMET

Gjatë javës së fundit nga rastet e hospitalizuara në Klinikën Infektive, Klinikën e Pediatrisë dhe spitalet rajonale janë raportuar 37 raste me ARI, 2 raste me ILI dhe 1 rast SARI.

SITUATA EPIDEMIOLOGJIKE NË RAJON DHE EVROPË

INFLUENCA SEZONALE JAVA 43/2025 NË EVROPË

Gjatë javës së fundit, pesë nga 31 vende dhe territore raportuese kanë shënuar nivele të rritura të raportimit të sëmundjeve të ngjashme me gripin (ILI) dhe/ose infeksioneve akute të rrugëve të frymëmarrjes (ARI), mbi nivelet bazë për këtë sezonë. Edhe pse aktiviteti i gripit mbetet nën pragun epidemik sezonal, shumica e treguesve kanë shënuar rritje graduale nga nivelet ndërsezonale, me disa vende që raportojnë rritje më të theksuara të aktivitetit të gripit.

Në nivel rajonal, aktiviteti i SARS-CoV-2 vijon një tendencë në rënie, megjithëse me variacione midis vendeve. Varianti XFG mbetet varianti dominues në qarkullim. Aktiviteti i RSV-së (virusit sincicial respirator) mbetet në nivele të ulta në gjithë rajonin.

Shkalla e sëmundjeve të ngjashme me gripin është mbi nivelin bazë në Austri dhe Kazakistan, ndërsa infeksionet akute të rrugëve të frymëmarrjes janë rritur mbi nivelin bazë në Gjermani, Lituani dhe Spanjë. Nga mostrat e marra në qendrat sentinel të ILI dhe ARI, përqindja e atyre që rezultuan pozitive për grip ishte 6%, nën pragun epidemik prej 10%, por me një rritje të lehtë krahasuar me javën e kaluar (5%). Mesatarja e vendeve që raportuan ishte 2%, ndërsa vetëm Irlanda e Veriut dhe Skocia (të dyja pjesë e Mbretërisë së Bashkuar) raportuan mbi 10% pozitivitet. Pozitiviteti për SARS-CoV-2 ra në 11% nga 13% një javë më parë, ndërsa për RSV mbeti i qëndrueshëm në 1%.

Nga 128 imotra pozitive të virusit të gripit të raportuara këtë javë nga mbikëqyrja sentinel në kujdesin parësor, 98% ishin të tipit A, me një shpërndarje ndërmjet nën-tipeve A(H3) (59%) dhe A(H1)pdm09 (41%). Asnjë vend nuk raportoi intensitet të mesëm ose të lartë të gripit, ndërsa tre vende (Norvegjia, Spanja dhe Irlanda e Veriut) raportuan përhapje gjeografike rajonale ose të gjerë të virusit.

Nga të dhënat e mbikëqyrjes sentinel për rastet SARI (infeksione të rënda akute të rrugëve të frymëmarrjes), 4% e mostrave rezultuan pozitive për virusin e gripit (krahasuar me 3% një javë më parë), 10% për SARS-CoV-2 (nga 8% më parë) dhe 1% për RSV. Shumica e mostrave pozitive të gripit në rastet SARI ishin të tipit A (97%), me nën-tipe të përziera midis A(H3) (55%) dhe A(H1)pdm09 (45%).

Shkalla e vdekjeve nga COVID-19 mbetet e ulët në 41 vendet raportuese. Analiza e përbashkët javore e EuroMOMO për vdekshmërinë nga të gjitha shkaqet në vendet pjesëmarrëse të Europës tregon nivele të pritura vdekshmërie në të gjitha grupmoshat.

Në përmbljedhje, megjithëse aktiviteti i gripit dhe viruseve të tjerë respiratorë në rajonin europian mbetet në nivele nën pragun epidemik sezonal, po vërehet një rritje graduale në disa vende, që sugjeron fillimin e fazës së hershme të sezonit respirator.

Burimi: <https://erviss.org/>